

as sot e kësaj dite. Rastet e tyre të zhdukjes janë evidentuar nga KNKK-ja. Lënda e Radomirit e mban numrin YUK-050080-01, ndërkaq ajo e Dragoljubit BLG-802980-01.

Burimet: deklarata S.M, FDH-6143; deklarata V.V, FDH-10920; deklarata V.V, FDH-18925; deklarata G.V, FDH-18922; deklarata V.S, FDH-5591; deklarata Xh.R, FDH-17151; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 960.

Fazli (Sadri) Raci

(15.10.1926, shqiptar nga Jelloci/Jelovac, komuna e Klinës/Klina, rojtar, shtatë fëmijë)

Në datën **20.06.1998**, pjesëtarë të UÇK-së i kanë rrëmbyer dy serb nga fshati [të shikohet regjistrimi i mëparshëm]. Nga frika prej hakmarrjes së policisë, tetë anëtarë të familjes Raci u larguan nga shtëpia, përderisa Fazliu i moshëthyer me bashkëshorten Miren, ndenjën në shtëpi. Në orët e paditës, në **Jelloc/Jelovac** hyri policia serbe. Pas pak, erdhën edhe te shtëpia e Fazliut. E kanë rrahur keq. E shqelmonin me çizmet dhe i shkelnin mbi duart. Pastaj, e çuan te postblloku policor te Fabrika e Kërpudhave në Jashanicë/Jošanica. Vazhduan ta rrihnin edhe më tutje. Pastaj, e çuan të udhëkryqi i Qupevës/Çupevo dhe e lanë aty. Fazliu arriti që të kthehej në shtëpi. Nga ora 17:00, ai me Miren e braktisën fshatin. Shkuan së pari në Reznik/Resnik. Një i afërm i ka çuar me makinë në spitalin e UÇK-së në Likoc/Likovac [Skënderaj/Srbica]. Ditën e nesërme, Fazliu me Miren shkuan në Prishtinë/Priština te djali Fadili. Pas një jave, Fazliu u paralizua nga dëmtimet që i shkaktuan keqtrajtimet e rënda fizike. Ndërroi jetë më 31.08.1998. E kanë varrosur në varrezat e Prishtinës/Priština më 1.09.1998.

Burimi: deklarata Xh.R, FDH-17151.

Oliver (Stevan) Zajić

(5.11.1980, serb nga Dushi i Vogël/Dušević, tregtar, komuna e Klinës/Klina)

Oliveri, i quajtur Giša, jetonte në bashkësi familjare me nënën Nikosaven dhe vëllain Zlatkon. Shtëpia e tyre gjendej përkaj pyllit, në periferi të fshatit [**Dush i Vogël/**

Dušević]. Në pranverë të vitit 1998, Oliveri e ka mbaruar shkollën për axhustator. Filloi nga puna në një shitore ushqimore pranë kooperativës bujqësore në Klinë/Klina. Në datën 20.06.1998, shqiptarët pa paralajmërim e kanë braktisur fshatin. Për këtë arsye, Oliveri me nënën dhe vëllain shkuan në Klinë/Klina dhe atje e kaluan natën. Në mëngjesin e datës **21.06.1998**, ata dëgjuan se situata në fshat ishte qetësuar dhe u kthyen në shtëpi. Rreth orës 13:00, përderisa në shtëpi drekonin burrat që ishin të angazhuar në mbrojtjen e fshatit, u dëgjuan të shtëna. Oliveri me burra dolën menjëherë jashtë duke tentuar që të arrinin te istikamet më të afërta. Por, në distancën prej afro 30 metrash larg shtëpisë së tij, një plumb snajperi e ka qëlluar Oliverin në gjoks. Ka mbetur i vdekur në vend. Një ditë më vonë, familjarët e kanë varrosur në varrezat e Klinës/Klina.

Burimet: deklarata Z.Z, FDH- 32099; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KKKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 905; *Dnevnik od 17. do 23. juna*, Ilustrovana politika, 2058, 27.06.1998, FDH-18837; R. Rmuš, *Bolna seta majke sa Kosmeta*, regjistrimi audio, FDH-32183; *Kosmet gnezdo albanskog terora, Talac-svoj narod!*, Večernje novosti, 6. 11.2003, FDH-32429.

Skender (Ymer) Ademi

(3.10.1947, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Klinës/Klina, minator, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Para shpërthimit të luftës, Skenderi ka jetuar dhe ka punuar në Zvicër. U kthye në fshatin e vet në muajin prill të vitit 1998 dhe menjëherë u bë anëtar i UÇK-së. Ka rënë në betejë me forcat serbe më **28.06.1998** në fshatin e tij të lindjes së **Drenocit/Drenovac**. Pas përfundimit të betejës më 30.06.1998, pjesëtarë të UÇK-së e kanë gjetur trupin e tij të pajetë në një fushë përmbyerë të shtëpinë e Skenderit. E varrosën në të njëjtën ditë në varrezat lokale. Më vonë, forcat serbe e zhvarrosën trupin e tij dhe e çuan në drejtim të panjohur. Vetëm më 24.01.2005, familjarët u ftuan zyrtarisht që t'i merrnin mbetjet mortore të Skenderit në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rrahovec/Orahovac. Ato u varrosën në Varrezat